



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

17 shkurt 2020

RrGK bën nderime te varri i Nexhmije Pagarushës për 17 shkurt

Anëtarët e Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) sot më 17 shkurt me rastin e përvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, bënë homazhe te varri i ikonës kosovare Nexhmije Pagarusha (1933-2020).

Në shenjë nderimi dhe respekti për jetën dhe veprën e Pagarushës, si një grua e fuqishme, anëtarët e RrGK-së vendosën lule te varri i saj në fshatin Pagarushë.

Kujtojmë se në vitin 2015 RrGK për Pagarushën ndau [mirënjohje](#) për “Guximin dhe veprat të cilat kanë motivuar dhe fuqizuar vajzat dhe gratë në Kosovë”.

Vepra e saj mbetet frymëzuese sot e përgjithmonë.